

VENDIM
Nr.973, datë 1.12.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË SHPALLJES E TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT
DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË
KRYERA NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE INSTITUCIONET E SAJ TË VARËSISË,
SI AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të institucioneve të saj të varësisë, si autoritete kontraktore, për të vijuar normalisht dhe për të përfunduar, brenda datës 31 dhjetor 2010, procedurat e prokurimit, me objekt:

- Blerje pullash kontrolli me elemente sigurie për barnat dhe aksesore për shtypjen e tyre për Qendrën Kombëtare të Kontrollit të Barnave;

- Blerje reagentësh dhe qelqurinash për Qendrën Kombëtare të Kontrollit të Barnave;

- Blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore për Shërbimin Psikiatrik, Shkodër.

Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, institucionet e saj të varësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha